

KUSHTET PER GARANCINE E KONTRATES

Neni 1

PËRKUFIZIME

Në këtë kontratë:

Garantuesi është Shoqëria e Sigurimit Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group sha;

I Siguruari është personi juridik apo fizik pjesëmarrës në tender;

Përfituesi është Enti Prokurues Shtetëror që organizon tenderin.

Neni 2

OBJEKTI I GARANCISË

Shoqëria e sigurimit detyrohet të dëmshpërblejë Përfituesin, deri në limitet e shumës së garantuar, në rast se I Siguruari nuk përmbush detyrimet e parashikuara në kontratën e lidhur me Përfituesin

Neni 3

VLEFSHMERIA DHE KOHËZGJATJA E GARANCISË

Vlefshmëria e kësaj garancie

3.1 fillon në orën 24.00 të ditës së pagesës së primit, dhe

3.2 mbaron në orën 24.00 të ditës së fundit të përcaktuar në Police.

Neni 4

SHUMA E GARANTUAR

Shuma e garantuar do të jetë ajo e përcaktuar në Formularin e Sigurimit.

Neni 5

RRITJA E SHUMËS SË GARANTUAR

Është në vartësinë e Shoqërisë së Sigurimit rritja vlerës së shumës së garantuar, sipas kushteve që do të negociohen nga palët, në rast se Përfituesi i bën një kërkesë për rritjen e kësaj shume të Siguruarit.

Neni 6

EKZEKUTIMI I GARANCISË

6.1 Shoqëria e sigurimit do të paguajë shumën sipas Nenit 4 brenda afatit të 30 ditëve nga mbërritja e kërkesës me shkrim nga Përfituesi, në rast se I Siguruari nuk përmbush detyrimet e parashikuara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur me Përfituesin. Përfituesi duhet të njoftojë

Shoqërinë e sigurimit brenda 30 ditëve nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit. Në bazë të nenit 1126 të Kodit Civil në rast mos respektimi të këtij afati Shoqëria e Sigurimit ka të drejtë të vendosë për pagimin ose jo të dëmshpërblimit.

6.2 I Siguruari deklaron se do të rimburojë Shoqëria e Sigurimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit prej saj, për gjithë shumën që ajo i ka paguar Përfituesit për mospërmbushjet e të Siguruarit..

6.3 Në rastin e mos kryerjes së detyrimit të pikës 6.2 I Siguruari detyrohet të paguajë shoqërisë së sigurimit 1% të shumës së garantuar për çdo ditë vonesë.

Neni 7

PRIMI

Primi që i Siguruari i detyrohet Kompanisë së Sigurimit, kompetencat dhe mënyra e pagimit do të llogaritet nga Shoqëria e Sigurimit sipas "Sistemit tarifor për kontratat e garantimit të ofertës dhe kontratës". Në rastet kur pagesa e primit nuk është kryer në afatet e zbatohen nenet 1125, 1129, e vijues të Kodit Civil.

Neni 8

DOKUMENTAT E BASHKËLIDHUR

Kusht për lëshimin e kësaj garancie është lidhja e Kontrates midis të Siguruarit dhe Përfituesit. Në rast se kjo kontratë nuk ekziston ose shpallet e pavlefshme atëherë edhe Shoqëria e Sigurimit nuk ka detyrim të paguajë shumën e sigurimit.

Neni 9

KOMPETENCAT PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRVESHJES

Në rast mosmarrëveshje midis Shoqërisë së Sigurimit dhe Përfituesit, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Tiranë.

Neni 10

APLIKIMI I LIGJIT

Për gjithçka që nuk është parashikuar në këto kushte do të aplikohet nenet 1113 e vijues të Kodit Civil.

G A R A N T U E S I

K O N T R A K T U E S I
